



RAPORTI VJETOR 2020



Përmbajtja:

1. Tregu i Sigurimeve në Shqipëri
2. Historiku i Vienna Insurance Group (VIG)
3. Vendet ku operon VIG
4. Historiku i Intersig VIG
5. Intersig në Shqipëri
6. Vlerat e Intersig VIG
7. Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG
8. Organizimi i Intersig VIG
9. Struktura e Aksionarëve
10. Principet e Menaxhimit
11. Stafi i Intersig VIG
12. Kapitali i Intersig VIG
13. Intersig VIG në Tregun Shqiptar
14. Shërbimet e ofruara
15. Raporti i Auditit të Brendshëm
16. Pasqyrat Financiare
17. Plan për 2021-2023
18. Kontakt


Tregu i Sigurimeve në Shqipëri

Tregu i Sigurimeve në Shqipëri

Tregu i të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2020 kapën vlerën mbi 16,608 milionë lekë, ose 5.73% më pak se viti 2019. Gjatë vitit 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 956,447 me një ulje prej 29.16% krahasuar me vitin 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.02%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.18% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.82% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 7,560 milionë lekë, ose 18.55% më shumë se viti 2019.



Historiku i Vienna Insurance Group (VIG)

Origjina e Grupit daton në 1824.



Themelimi i Wechselseitige k.k.priv. Branschaden Versicherungs-Anstalt, shoqëria e parë paraardhëse e Grupit.

Lufta e Dytë Botërore

Të dyja godinat e zyrave në Kärntner Ring në Vjenë u shkatërruan gjatë sulmeve ajrore. Pas përfundimit të luftës filloi rindërtimi i shoqërisë me një grup të vogël punonjësish.



1952

Vendoset një zyrë e re qendrore në Schottenring të Vjenës.



14 Qershor 1955

Hapet Ringturm – ndërtesa e parë e lartë moderne e zyrave në Austri. Ajo simbolizon rimëkëmbjen ekonomike të Austrisë pas luftës dhe rifitimin e lirisë.



1971

Blerja e një aksioni në Donau Versicherung AG (themeluar në 1867) vendosi themelin e strategjisë së sotme multi-markë.



1990

Planet fillestare për zgjerim në Evropën Lindore dhe themelimi i Kooperativa në Bratislavë, në çfarë ishte Çekosllovakia, si siguruesi i parë privat në bllokun e atëhershëm Komunist.



Tetor 1994

Aksionet e para preferenciale të Grupit listohen në Bursën e Vjenës.

2006

Prezantimi i Grupit si brand "Vienna Insurance Group" u bë në fillim të vitit 2006.



Që prej 2006

Ringturm mbulohet në mënyrë të rregullt me veshje artistike, si kontribut ndaj artit në hapësira publike. Mbështjeëja krijohet nga artistë nga Austria si dhe shtete të Europës Qendrore ku Vienna Insurance Group operon.

2008

Rritja e dytë e kapitalit e rrit në mbi 1 bilion Euro; marrëveshje bashkëpunimi me Erste Group.

2010

Krijohet VIG Holding, njësi menaxhuese e Grupit.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP

Vendet ku operon VIG

INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP



Historiku i Intersig **VIG**



■ 2001

2001 Intersig u themelua në vitin 2001 nga një grup aksionarësh vendas të cilët morën licencën për një kompani jo-jete në Republikën e Shqipërisë.

■ 2001 – 2011

Intersig pati një rritje të qëndrueshme në market share. Vienna Insurance Group bleu shumicën e aksioneve të Intersig Sha., në bazë të një marrëveshjeje të firmosur në 25 Gusht 2011 në Tiranë

■ 2011 – Sot

Aktualisht, VIG zotëron 90% të aksioneve të Intersig VIG. Intersig e cila u pajis gjithashtu me një logo të re, dhe fakti që është në zotërimin e VIG, ka influencuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Intersig VIG ka reformat shumë procese duke investuar në përmirësimin e kualitetit të stafit dhe digjitalizimin e shumë proceseve.

Krijimi i produkteve të reja si Sigurimi i Shëndetit, Eas Casco etj janë bërë pjesë e portofolit të Intersig VIG



Intersig në Shqipëri

- Zyrat Qendrore të Intersig VIG janë në Tiranë dhe Intersig VIG është i përfaqësuar në të 13 rajonet e Shqipërisë.
- Shoqëria operon në bazë të një rrjeti të gjerë të degëve, agjencie dhe pikave të shitjes.
- Në fund të vitit 2020, shoqëria ka punësuar një numër prej rreth 136 punonjësish.



Vlerat e Intersig VIG



Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG



▪ Vizioni

Ne jemi pjesë e një grupi udhëheqës të sigurimeve dhe shërbimeve financiare që kërkon vazhdimisht rritje të qëndrueshme. Ne dëshirojmë të jemi agjensia e sigurimit e zgjedhur, e përkushtuar për edukimin, shërbimin dhe mbrojtjen e familjeve dhe bizneseve vendore, me politikat më të mira dhe me çmimin e duhur. Vizioni ynë është të vendosim standardin e përsosmërisë midis ofruesve të sigurimeve duke qenë inovator, të fortë financiarisht, duke siguruar mbështetjen dhe shërbimin e duhur për klientët tanë.


▪ Misioni

Dedikimi për të qenë shoqëri lider në Shqipëri në sajë të produkteve kompetitive dhe shërbimit me kualitet që ofrojmë. Përpiqemi që çdo ditë të veprojmë me integritet, kërkojmë dhe përqafojmë larminë, dëgjojmë, edukojmë dhe mësojmë, ofrojmë zgjidhje, gjenerojmë energji pozitive dhe mbështesim komunitetin tonë. Ne ofrojmë risi dhe përsosmëri në produktet dhe shërbimet tona. Në gjithçka që bëjmë, jemi të përkushtuar të shkojmë përtej pritshmërive. Gjithmonë do të mbetemi fleksibël dhe inovues, në mënyrë që të jemi në gjendje t'i adresojmë nevojat në varësi të klientëve tanë. Ne krijojmë vlera solide.

Premtimi ynë: Make Life Easy!

Premtimi i VIG: Protecting What Matters!

Organizimi i Intersig VIG




* Intersig VIG obtains (transferred) back office services from the company VIG Services Shqiperi, such as: Finance & Accounting; IT and Claim Handling.

** Services shared between two companies: Intersig VIG and Sigma Interalkanian, which are both part of Vienna Insurance Group.

Struktura e Aksionarëve

■ Vienna Insurance Group ■ Gentian Sula




Struktura e Këshillit Mbikëqyrës

- | | |
|----------------------|--------------|
| ■ Z. Peter Hoefinger | Kryetar |
| ■ Z. Christoph Rath | Zv. Kryetar |
| ■ Z. Michael Hack | Anëtar Bordi |

Struktura e Bordit Drejtues


- | | |
|----------------------|------------------------|
| ■ Z. Gentian Sula | Drejtor i Përgjithshëm |
| ■ Znj. Fitnete Sulaj | Anëtare Bordi |
| ■ Z. Fatmir Bërdica | Anëtar Bordi |

Principet e Menaxhimit




Stafi i Intersig VIG

- Kombinimi i moshave të ndryshme me qëllim ndërveprimin e eksperiencave
- Fokus në stafin e ri dhe profesional
- Trajnime të vazhdueshme brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Mundësi të barabarta për rritje në karrierë
- Motivim i lartë



Kapitali i Intersig VIG

PRIME TË SHKRUARA FAKTIKE 2013-2019 DHE PLANI 2020-2022



Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prime Mil ALL	6.28	10.38	15.68	16.01	16.66	16.78	18.14

Viti	2020	2021	2022	2023
Prime Mil ALL	15.4	17.58	19	19.8


Intersig VIG gjatë vitit 2020 ka shkruar rreth 15,4 milion ALL prime, ose 14.64 % më pak se 2019.

Intersig VIG gjatë vitit 2021 ka planifikuar të realizojë 17.58 milion ALL Prime të shkruara.

Intersig VIG në Tregun Shqiptar


Intersig ka 10% të tregut për Primet e shkruara në vitin 2020 me rreth 15,4 milion ALL.
Intersig ka paguar rreth 6,2 milion ALL dëme gjatë vitit 2020. Numri i kërkesave të Dëmeve të paguara nga Intersig gjatë vitit 2020 është 9,001 ose 8.97% e gjithë kërkesave të tregut.

Tregu për Primet e Shkruara Bruto




■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëmet e paguara në vlerë



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëmet e paguara në numër



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Shërbimet e ofruara

1

SIGURIME NË TRANSPORT

2

SIGURIMI I SHËNDETIT

3


SIGURIMI I PASURISË

4

SIGURIME MOTORIKE

5

SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË DHE I GARANCIVE



Raporti i Auditit të Brendshëm

Përmbledhje e aktivitetit të Auditit të Brendshëm për vitin 2020

Auditimet dhe kontrollet e kryer gjate vitit 2020 kane synuar te mbulojne te gjitha aktivitetet e shoqerise INTERSIG VIG ne perputhje me planin vjetor te miratuar ne Keshillin Mbikqyres.

Angazhimet audituese jane finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet perkatese, te cilat jane pasqyruar ne raportet e auditimit te derguara ne Bordin te Drejtoreve te Shoqerise INTERSIG VIG sha.

Drejtori i Njesise se Auditit te Brendshem ka qene ne komunikim te vazhdueshem me Komitetin e Auditimit dhe me Bordin Drejtues per diskutimin e perfundimeve te raporteve te auditimit, duke marre mbeshtetje te plote nga ana e tyre, per realizimin e rekomandimeve.

Në mënyrë të vazhdueshme Njesia e Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar shkallen e realizimit te rekomandimeve të miratuara ne Komitetin e Auditimit dhe statusin përfundimtar të tyre.

Bazuar ne auditimet e kryera ne fushat e veprimtarise se Shoqerise se sigurimeve INTERSIG VIG mund te jepet siguri i arsyeshme se menaxhimi i rrezikut, qeverisja e shoqerise dhe proceset e kontrollit të brendshëm kane funksionuar në mënyrë efektive.

Perfundimi i arritur nga auditimet e realizuara eshte se gjate vitit 2020 nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale te konsiderueshme, të cilat të kenë një ndikim domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.



Klasifikimi i Auditimeve të Brendshme

Auditimet e realizuara gjate vitit 2020 klasifikohen ne baze te natyres te auditimit: auditime te perputhshmerise (compliance), auditime financiare, auditime te performances (3E: Kursim – Dobi – Frytshmëri) dhe auditime te teknologjise se informacionit; ne baze te llojit te sherbimit auditues: auditime te dhenies se sigurise dhe auditime me natyre keshilluese; si dhe ne baze te fushes se veprimtarise qe kontrollojne, ku cdo vit jane perfshire keto fusha:

Shitje, Marrje ne Sigurim, Trajtim Demi, Administrim, Finance, Teknologji Informacioni, Risigurime, Burime Njerezore, Aktivitetet e Degeve te Shoqerise dhe Sistemin e qeverisjes.

Si planifikimi vjetor i auditimit te brendshem, ashtu edhe realizimi i angazhimeve audituese gjate vitit 2020, jane bazuar ne kriteret e analizes se riskut dhe kane synuar t'i japin menaxhimit te larte siguri te arsyeshme per ecurine dhe mbarevajtjen e te gjitha aktiviteteteve te shoqerise se sigurimit INTERSIG VIG.

Per nje periudhe kohore afat-mesme (bazuar ne planin strategjik tre vjecar te miratuar ne Keshillin Mbikqyres dhe ne Departamentin e Auditimit te Brendshem te Grupit VIG), Njesia e Auditimit te Brendshem ne Shoqerine INTERSIG VIG ka analizuar dhe ri-vleresuar mbi baze risku gjithsej 60 tema auditimi, nga te cilat:

- 26 tema jane vleresuar me nivel te larte te riskut (frekuenca e auditimit te tyre eshte cdo vit ose dy here ne vit),
- 28 tema me nivel risku mesatar (me frekuenca auditimi nje here ne dy vjet) dhe
- 6 tema me nivel te ulet risku (me frekuenca auditimi nje here ne tre vjet).



Pasqyrat Financiare

Intersig Vienna Insurance Group SH.A.

**Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit
Financiar dhe
Skedulet Suplementare
më 31 dhjetor 2020**

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Intersig Vienna Insurance Group SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Intersig Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përfshijnë "Aftësinë paguese" dhe "Aktivet në mbulim të rezervave teknike", por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar të raportojmë këtë çështje. Ne nuk kemi diçka për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.




Auditues Ligjer
Jonid Lamllari

9 prill 2021
Tiranë, Shqipëri

Intersig Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive të trupëzuara	11	289,623	103,049
Aktive të patrupëzuara	12	13,324	17,988
Aktive me të drejtë përdorimi	13	35,043	61,495
Aktive të mbajtura për investime	14	170,613	179,593
Aksione në shoqëri të lidhura	15	18,454	12,566
Aktive të risigurimit	16	998,516	1,090,699
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	17	968,349	901,637
Depozita me afat me banka	18	733,103	745,546
Aktive të tjera	19	64,267	72,855
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	20	231,567	224,020
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	21	91,347	118,745
Tatim fitimi i parapaguar		-	710
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22	119,061	133,677
TOTALI I AKTIVEVE		3,733,267	3,662,580
KAPITALI			
Kapitali aksionar	23	417,471	417,471
Rezerva e rrezikut të sigurimit		41,747	41,747
Fitime të mbartura		293,499	204,062
TOTALI I KAPITALIT		752,717	663,280
DETYRIMET			
Detyrime për kontratat e sigurimit	24	1,300,227	1,307,534
Rezerva për primet e pafituara	25	838,020	878,575
Depozitë e risiguresit	26	676,217	641,826
Detyrime për qira	13	35,554	60,529
Detyrime tatimore dhe të tjera	27	27,042	28,791
Tatim fitimi i pagueshëm		2,255	-
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	28	101,235	82,045
TOTALI I DETYRIMEVE		2,980,550	2,999,300
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		3,733,267	3,662,580

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 26 mars 2021 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Gentian Sula
Drejtor i Përgjithshëm



Ilir Elmazi
VIG Services SH.P.K.

Intersig Vienna Insurance Group SH.A.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	2020	2019
Prime të shkruara bruto	29	1,547,527	1,814,338
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	25	40,555	(102,524)
Të ardhura nga primi i sigurimit		1,588,082	1,711,814
Prime të ceduara të risiguresit	30	(716,947)	(855,073)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primet e pafituara	25	(37,799)	61,526
Prime të ceduara të risiguresit		(754,746)	(793,547)
Prime të fituara neto		833,336	918,267
Të ardhura të tjera	31	20,001	13,345
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	32	362,677	419,802
Të ardhura nga investimet	33	60,704	57,172
Të ardhura neto		1,276,718	1,408,586
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	24	7,307	(420,619)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguresit	24	(54,384)	344,398
Dëme të paguara, bruto	24	(668,388)	(636,722)
Dëme të paguara nga risiguresi	24	335,269	260,146
Dëme të sigurimit, neto		(380,196)	(452,797)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	34	(460,274)	(498,706)
Shpenzime administrative	35	(290,502)	(302,553)
Provizion për humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	21	(2,299)	-
Shpenzime të tjera nga aktiviteti i sigurimit	36	(31,773)	(34,453)
Shpenzimet		(1,165,044)	(1,288,509)
Shpenzime financiare	37	(10,276)	(10,004)
Fitim/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	38	7,260	(6,242)
Fitimi para tatimit		108,658	103,831
Tatimi mbi fitimin	39	(19,221)	(16,887)
Fitimi i vitit		89,437	86,944
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		89,437	86,944

Intersig Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	417,471	41,747	142,169	601,387
Fitimi i vitit	-	-	86,944	86,944
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	86,944	86,944
Shpërndarje dividend	-	-	(25,051)	(25,051)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	417,471	41,747	204,062	663,280
Gjendja më 1 janar 2020	417,471	41,747	142,169	601,387
Fitimi i vitit	-	-	89,437	89,437
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	89,437	89,437
Gjendja më 31 dhjetor 2020	417,471	41,747	293,499	752,717

Intersig Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	2020	2019
Fitimi para latimit		108,858	103,831
Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	35	54,794	51,045
Fshirje/Pakësime		623	-
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	21	2,299	-
Shpenzime interesi	37	10,276	10,004
Të ardhura nga investimet	33	(60,104)	(57,112)
Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit		115,946	107,708
Ndryshime në aktive të risigurimit		92,183	(405,924)
Ndryshime në aktive të tjera		8,588	3,613
Ndryshime në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(7,547)	(37,119)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera		25,099	(32,986)
Ndryshime në detyrime të kontratave të sigurimeve		(7,307)	420,619
Ndryshime në rezervën e primit të paguar		(40,555)	102,524
Ndryshime në depozitën e risiguruesit		34,391	72,793
Ndryshime në detyrime tatimore dhe të tjera		(1,749)	4,437
Ndryshime në llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		19,190	(21,836)
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit		238,239	213,829
Interes i marrë		57,547	40,837
Interes i paguar		(9,407)	(8,348)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(16,256)	(20,884)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		270,123	225,434
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje aktive të trupëzuara	11	(203,334)	(64,338)
Blerje aktive të patrupëzuara	12	(130)	(1,781)
Blerje e letrave me vlerë	17	(325,000)	(74,100)
Letra me vlerë të maturuara	17	259,964	48,873
Ulje/(Rritje) në depozitat me afat		13,924	(6,990)
Aksione në shoqëritë e lidhura		(5,888)	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(260,464)	(98,336)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Pagesat e qirave	13	(24,275)	(22,997)
Pagesat e dividendit		-	(25,051)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese		(24,275)	(48,048)
Rritja neto nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to		(14,616)	79,050
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		133,677	54,627
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	22	119,061	133,677

Plani për 2021-2023

Gross Written Premium - Primet Bruto

ALL	2019	Plan 2020	Fakt 2020	2021	2022	2023
Direct Business						
1 Accident insurance	30,342,461	37,000,000	17,141,501	25,000,000	35,000,000	41,000,000
2 Health	94,548,582	110,000,000	109,090,693	110,000,000	113,000,000	115,000,000
3 Land vehicle casco insurance	57,633,249	63,000,000	42,204,442	56,000,000	65,000,000	68,000,000
4 Rail vehicle casco insurance		500,000		500,000	500,000	500,000
5 Aircraft casco insurance	30,951,247	36,000,000		25,000,000	30,000,000	32,000,000
6 Marine, lake and river navigation casco ins.	3,708,878	5,000,000	-	-	6,000,000	7,000,000
7 Transport insurance	11,010,614	4,000,000	751,370	2,500,000	4,000,000	5,000,000
8 Fire and natural hazard insurance	183,717,876	195,000,000	90,730,434	140,000,000	162,000,000	180,000,000
9 Other property insurance (w exp. of 3-7)	-					
10 Land vehicle MTPL	1,307,126,353	1,365,000,000	1,216,353,911	1,310,000,000	1,382,000,000	1,422,000,000
DMTPL	1,046,679,216	1,080,000,000	1,067,427,449	1,090,000,000	1,127,000,000	1,150,000,000
Green Card	207,924,458	220,000,000	122,180,257	170,000,000	200,000,000	215,000,000
Border	52,522,679	65,000,000	26,746,205	50,000,000	55,000,000	57,000,000
11 Aircraft liability insurance	12,733,962	19,000,000	8,153,919	16,000,000	20,000,000	20,000,000
12 Marine, lake and river navigation liab. ins.	1,011,678	2,000,000	153,658	2,000,000	4,000,000	4,000,000
13 General liability insurance	52,597,604	33,500,000	43,919,764	44,000,000	45,000,000	47,000,000
14 Credit insurance				-		
15 Guarantee insurance	15,503,284	21,000,000	16,132,731	17,000,000	22,000,000	25,000,000
16 Several financial losses						
17 Legal expenses insurance				-		
18 Assistance insurance, travel	13,324,087	15,000,000	4,016,385	10,000,000	11,500,000	13,500,000
Total	1,814,209,875	1,906,000,000	1,548,648,808	1,758,000,000	1,900,000,000	1,980,000,000

Vullnetare	507,083,522	541,000,000	332,294,897	448,000,000	518,000,000	558,000,000
Pesha e vullnetareve	28.0%	28.4%	21.5%	25.5%	27.3%	28.2%
Rritja e vullnetareve	24.9%	6.7%	-34.5%	34.8%	15.6%	0.0%
			-19%		22.7%	

INTERSIG®

VIENNA INSURANCE GROUP

KONTAKT :

Dega Qendrore

Rruga : "Ismail Qemali", Samos Tower,
Kati I 2-të, Ish-Bllok, Tirane.
Tel : +355 (0) 4 22 70 576
E-mail : info@intersig.al